

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës
Nr. 002/13
Datë:27.02.2026

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr.03/L-40, si dhe në përputhje me Statutin e Komunës së Junikut dhe kompetencat e Kuvendit Komunal për planifikim dhe zhvillim lokal, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tijë të rregullt të mbajtur më 27.02.2026 nxjerrë:

VENDIM

Për inicimin e procedurave për hartimin e "Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026-2033"

I. Miratohet inicimi i procedurave për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Junikut për periudhën 2026-2033.

II. Qëllimi i kësaj strategjie është:

- Të promovoj zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm në Komunën e Junikut,
- Të identifikoj prioritetet strategjike për zhvillim ekonomik lokal,
- Të përmirsojë klimën e investimeve dhe mbështetjen për bizneset lokale,
- Të krijoj mundësi të reja për punësim dhe zhvillim të sektorëve ekonomikë lokal.

III. Për koordinim dhe hartimin e strategjisë do të formohet Grupi punues Komunal, i përbërë nga përfaqësues të drejtorive komunale relevante, sektorit privat, shoqërisë civile dhe palëve të tjera të interesit.

IV. Procesi i hartimit të strategjisë do të përfshijë:

- Analizën e gjendjes aktuale ekonomike të Komunës,
- Konsultime me komunitetin e biznesit dhe qytatërët,
- Konsultime publike sipas legjislacionit në fuqi,
- Përgaditjen e planit të veprimit dhe prioriteteve zhvillimore.

V. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës së Junikut, përkatësisht Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, e cila do të koordinojë procesin e hartimit të strategjisë.

VI. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL,
- Kryetari i Komunës së Junikut,
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik
- Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
- Arkivi i Komunës së Junikut

Kryesuesi i Kuvendit
z. Leonard Tolluni